



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËVE SLLAVE DHE
BALLKANIKE



PROGRAMI I LËNDËS
Tipologji Tekstore

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore (40 seminare)

Viti / Semestri : Viti II, semestri II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor – Gjuhë, letërsi dhe qytetërim turk

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Ky kurs synon të paraqesë një hyrje në teoritë themelore të tipologjisë së teksteve parë në marrëdhëniet me disiplinat e tjera, kuptimet dhe format gramatikore, konceptet themelore të strukturës gramatikore, karakteristikat themelore të pjesëve të ligjëratës, dhe modelet moderne të analizës së tekstit.

Objektivat specifike lëndore:

1. Ky kurs do të identifikojë dhe analizojë në mënyrë të detajuar të gjitha llojet e teksteve.
2. Në fund të këtij kursi studenti do të jetë i aftë të identifikojë dhe veçojë konceptet dhe format themelore të teksteve; të analizojë disa lloje tekstesh.

Rezultatet e pritshme:

1. Identifikojë dhe klasifikojë lloje të ndryshme të teksteve, në bazë të strukturës, funksionit dhe kontekstit të tyre komunikativ.
2. Zbatojë konceptet dhe format themelore gramatikore në analizën e teksteve, duke kuptuar marrëdhëniet ndërmjet strukturës dhe kuptimit.
3. Analizojë tekste të ndryshme duke përdorur modelet moderne të analizës, dhe të vlerësojë lidhjet ndërdisiplinore të teksteve me fusha të tjera studimore.